



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opštine/Mayor's Office

Date/ 15/05/2025

Nr/02/ 556

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale si dhe sipas nenit 54 të Statutit të Komunës së Shtimes, në pajtim me nevojën e mbikëqyrjes së zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Komunës së Shtimes, Postës së Kosovës dhe Policisë së Kosovës të datës 06.05.2025 për Kryerjen e Shërbimeve Postare (Shpërndarje e Dërgesave/Gjobave të Trafikut Rajonal), Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M

1. Z.Ymri Behluli caktohet përgjegjës dhe mbikëqyrës i Marrëveshjes së datës 06.05.2025 mes Komunës së Shtimes, Postës së Kosovës dhe Policisë së Kosovës për Kryerjen e Shërbimeve Postare (Shpërndarje e Dërgesave/Gjobave të Trafikut Rajonal).
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e mbikëqyrjes së zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të datës 06.05.2025 sipas kushteve dhe kriterëve të parapara bazohen në legjislacionin në fuqi që e rregullojnë këtë çështje.
3. Z.Ymri Behluli ushtron detyrën sipas pikës 1 të dispozitivit të këtij Vendimi deri në përfundim të Marrëveshjes ose deri në ndryshimin e këtij Vendimi.
4. Z.Ymri Behluli do t'i kryejë detyrat përkatëse që dalin nga Marrëveshja e Bashkëpunimit dhe sipas nevojës do të jetë në bashkërendim me përgjegjësit e caktuar nga institucionet që janë palë e Marrëveshjes.
5. Obligohet administrata komunale në Komunën e Shtimes për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrim.

Iu dërgohet:
Postës së Kosovës
Policisë së Kosovës
Arkivi



Kryetari i Komunës
Qemal Aliu